



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2023:176401  
Datë: 31.05.2024  
Numri i dokumentit: 05761286

C.2023:176402

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI CIVIL, me gjyqtaren Kreshnike Zymberi Beqiri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I. A. nga ..., të cilin e përfaqëson av. Visar Musa nga Ferizaj, kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm Ferizaj, me objekt kontesti paga jubilarë, jashtë seance më datë 31 maj 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET POSHTË SI E PALEJUAR padia e paditësit I. A. nga Ferizaj, e ushtruar kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj, për çështjen juridike paga jubilarë.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarës së saj me datë 18.08.2023 në këtë gjykate ka parashtruar padinë kundër të paditurës, për çështjen juridike kompensim i pagave jubilarë me rastin e 10 vjetorit të punës.

Duke vepruar sipas padisë së paditësit, gjykata i ka dorëzuar të paditurës Aktvendimin për Përgjigje në Padi ndërsa me datë 14.09.2023 e paditura ka dorëzuar përgjigjen në pasi, në shqyrtimin paraprak të padisë, ka gjetur se në shkresat e lëndës është si provë materiale Aktgjykimi i datës 26.01.2023 me numër C.....i kësaj gjykate, ku nga ky aktgjykim shihet se paditësit i është njohur e drejta në kompensimin e pagave jubilarë për 10 vjetorin e punës, me ç'rast edhe është konstatuar se në këtë çështje kontestimore, kemi të bëjmë me çështjen e gjykuar

- *res judicata*, ngase për këtë çështje dhe ndërmjet këtyre palëve tani më njëherë është vendosur nga ana e kësaj gjykate.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 391 pika (d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- DIVIZIONI CIVIL  
C.2023:176402, me datë 31 maj 2024

Gjyqtarja  
Kreshnike Zymberi Beqiri

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, nëpërmjet të kësaj gjykate.